



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:258699

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05713104

C.nr. 827/2023

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve: M., D. B.dhe R. F., të cilat sipas autorizimit i përfaqëson Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës - Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin në bazë të inflacionit, me vlerë të kontestit 2,124.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 21.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëseve: M., D. B. dhe R. F., DETYROHET e paditura Komuna e Kamenicës, që paditëseve t'i paguaj edhe atë, për:

1. M.S., në emër të inflacionit për vitin 2021 për 3.4% të inflacionit, shumën prej 171.00 euro dhe për vitin (*janar – nëntor*) 2022, për 11.60% të inflacionit, shumën prej 537.00 euro, këto në shumë të përgjithshme të hollave prej **708.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

2. D.B., në emër të inflacionit për vitin 2021 për 3.4% të inflacionit, shumën prej 171.00 euro dhe për vitin (*janar – nëntor*) 2022, për 11.60% të inflacionit, shumën prej 537.00 euro, këto në shumë të përgjithshme të hollave prej **708.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

3. R. F., në emër të inflacionit për vitin 2021 për 3.4% të inflacionit, shumën prej 171.00 euro dhe për vitin (*janar – nëntor*) 2022, për 11.60% të inflacionit, shumën prej 537.00 euro, këto në shumë të përgjithshme të hollave prej **708.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura, që paditësve t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 238.00 euro, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

### A r s y e t i m i

Paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 09.11.2023, në këtë gjykatë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin në bazë të inflacionit, në emër të inflacionit për vitin 2021 për 3.4% të inflacionit, shumë prej nga 171.00 euro dhe për vitin (janar – nëntor) 2022, për 11.60% të inflacionit, shumë prej nga 537.00 euro, këto në shumë të përgjithshme të hollave per secilin paditëse prej nga 708.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive të Arsimit, neni 35, paragrafi 10. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën t'ia kompensojë diferencën në pagë në bazë të inflacionit në shumat e lartëcekura. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 208.00 euro për përpilimin e padisë, 30.00 ne emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësit.

E paditura përmes përgjigjes në padi, ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura, mirëpo KKAK nuk është regjistruar në MPMS-së, ashtu siq kërkohet me Udhëzimin Administrativnr.12/2021, për regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive, nga ky fakt nuk prodhon efekt juridik, po ashtu ka theksuar se në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.5/2017, “licenca për mësimdhënësit lëshohet për një periudhë 5 vjeqare ndersa paditësi është me licencë të skaduar dhe të njejtit nuk kan zbatuar udhëzimin administrativ lidhur me vazhdimin e licencës. Po ashtu ka theksuar se Qeveria me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi ka qenë e obliguar që të bëjë rritjen e të hyrave për komunat sidomos për komunën e Kamenicës, në kategorinë e pagave, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia dhe kërkesë padia e paditësve për arsyet e cekura më lartë.Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është tërësisht e bazuar.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditëset janë të punësuara pranë të paditurës, as paga bazë apo kompensimet e shtesave, por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim e inflacionit vjetor për paditëset. Ndërsa kërkesa e paditësve për shpërblimin në bazë të inflacionit, bazën ligjore e ka në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /Kontrata e datës 18.04.2017, ngase në nenin përkatës është përcaktuar se: “ *Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.*”, e në rastin konkret gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve në të dhënat se shkalla mesatare vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, për vitin 2021 për 3.4% të inflacionit, shumë prej 171.00 euro dhe për vitin (janar – nëntor) 2022, për 11.60% të inflacionit, shumë prej 537.00 euro, këto në shumë të përgjithshme të hollave për secilen paditëse prej nga 708.00 euro.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “ *kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merit, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtave subjektive të paditësit dhe lartësisë së tij, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe Kontratës kolektive në fuqi të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 7 të kësaj Kontrate, si dhe Mendimit juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Po ashtu gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merit, pasi themelësia e kërkesëpadiës, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / Kontrata e datës 18.04.2017, citohet: “ *Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë*”, në rastin konkret për vitin 2021 dhe për vitin (janar – nëntor) 2022.

Në rastin konkret, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësve në emër të inflacionit mesataren vjetore prej 3.40% për vitin 2021 dhe për 11.6% për vitin (janar-nëntor) 2022, këto në shumë për secilen paditëse prej nga 708.00 euro.

Nga këto arsye, gjykata detyroi të paditurën t'ia kompensojë shumën e përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit në bazë të inflacionit.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ashtu që ia njohi kërkesën e shpenzimeve sa i përket përpilimit të padisë dhe taksës gjyqësore, si shpenzime të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË  
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil  
C.nr.827/23, më datë 21.05.2024

Gjyqtarja,  
Valbonë Dërvodeli, d.v

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.